



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 04 datë 28.05.2025

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “SHITESË OBJEKTI 1
KAT DHE RIKONSTRUKSION I SHKOLLËS “ENVER QIRAXHI” DHE
PALESTRËS EKZISTUESE”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË POGRADEC

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, me propozim të zhvilluesit Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:


1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Shtesë objekti 1 kat dhe rikonstruksion i shkollës “Enver Qiraxhi” dhe palestrës ekzistuese”, me vendndodhje në Bashkinë Pogradec, me zhvillues Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuesit vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Pogradec.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I EKONOMISË DHE INOVACIONIT
DELINA IBRAHIMAJ



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 02/02 2026